

VENDIM
Nr. 56, datë 2.4.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “HYDROBORSH” SHPK, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) E ASETEVE TË
PALUAJTSHME TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 2, germa “a”, 3, 4, gjerat “a” dhe “b”, 5, germa “j”, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 1.3 dhe pikës 1.6, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 770/1 prot., datë 29.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hydroborsh’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve të paluajtshme të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydroborsh” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Fterra” (1.08 mw) dhe “Fterra 2” (2 mw) me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 67, datë 6.6.2012.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770 prot., datë 12.3.2024, shoqëria ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve të paluajtshme të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se shoqëria “Hydroborsh” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pikat 1, gjerat: “a”, “b”, “c”, “P” dhe “g”; 3, 4 dhe 6.

Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 7, pika 1:

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë gjendjen e saj financiare aktuale dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- germa “d”: Shoqëria duhet të depozitojë një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferimin e aseteve;

- germa “h”: Shoqëria duhet të depozitojë listën e aseteve, ku të përcaktohet vlera e secilit aset dhe vlera totale e aseteve që kërkon të transferojë (hipotekojë) në favor të bankës;

- germa “i”: Shoqëria duhet të depozitojë deklaratën me shkrim të personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit;

- germa “j”: Shoqëria duhet të informojë ERE-n nëse ka pasur transferimit të aseteve të kryera më herët.

Për gjithë sa më sipër, Bordin i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve të paluajtshme

të saj për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredithënëse “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë, palën huadhënëse, si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi